

Sistemi bankar e kreditor dhe ndikimi i tij në zhvillimin ekonomik

*Refik Kryeziu**

Përmbledhje

Sistemi bankar në Republikën e Kosovës është i ri.

Funksionimi i këtij sistemi filloi një vit mbas përfundimit të luftës.

Mbase 90% të asetëve të bankave kryesisht janë të kapitalit të huaj.

Përveç Bankës Qendrore funksionojnë edhe tetë banka komerciale, në të cilën vetëm dy prej tyre janë me kapital vendor.

Produktet kryesore të domosdoshme për një institucion financiar, për t'i përmbushur kushtet për të qenë bankë, janë punët e depozitave dhe të kredive, si dhe produktet e shërbimet e tjera e që në kohët e fundit janë duke u shtuar.

Gjatë funksionimit të sistemit bankar kemi një zhvillim të hovshëm të depozitave dhe të kredive.

Përderisa, në fund të vitit 2000 shuma e depozitave të klientëve ishte 93 milionë euro, fund i vitit 2010 shënoi rritje të depozitave në vlerë prej 1 miliard e 952 milionë euro.

Në fund të vitit 2000 shuma e kredive të lejuara për individ dhe biznese, kishte arritur në shumë prej 3 milionë euro, ndërsa në dhjetor të vitit 2010 kemi një vlerë prej 1 miliard e 439 milionë euro.

Në bankat e Kosovës gjatë vitit 2006 dhe 2007 kreditë e këqija ishin 4.1 %, derisa në vitin 2008 kishte rënie në 3.3 %, në vitin 2009 ishin 4.3 % dhe në gjashtëmuorin e parë të vitit 2010 me 4.5 % të kredive të përgjithshme.

Normat e interesit për kredi janë shumë të larta në krahasim me bankat komerciale të vendeve të rajonit dhe më gjerë. Sistemi bankar është i varfër, kërkesat për kredi dhe shërbime bankare janë të mëdha.

Fjalë kyç: Sistemi bankar, Banka qendrore, produktet e bankës, depozitat, kreditë, normat e interesit.

Hyrje

Veprimtaria e bankave në Republikën e Kosovës është e përcaktuar dhe e rregulluar me aktin e themelimit të tyre. Marrë në përgjithësi

* Refik Kryeziu, Fakulteti Ekonomik, BPrAL AAB, Prishtinë.
refik.kryeziu@universitetiaab.com

sistemi bankar është shumë i ngjashëm me sistemin bankar në shtetet në tranzicion.

Karakteristikë e politikës ekonomik e me këtë edhe të zhvillimit ekonomik të vendit, përveç formave të ndryshme të arriturave, është edhe duke u shpërndarë kredi për klientët, për bizneset dhe për qytetarë të ndryshëm në sasi dhe afate të ndryshme nga bankat komerciale.

Që nga fillimi i funksionimit të veprimit të bankave komerciale, që është një periudhë mbi 10 vjeçare, prapëseprapë në treg dominojnë norma të larta të interesit për kreditë, që në një masë është barrë për subjektet ekonomike e me këtë edhe për ekonominë në përgjithësi.

Shikuar nga aspekti i zhvillimit dhe funksionimit të këtij sistemi, si dhe të nevojave dhe kërkesave të mëdha të ekonomisë për këto institucione, kuptojmë se sistemi bankar në Kosovë ende nuk është i zhvilluar aq sa duhet.

Aspekte të funksionimit të bankave

Në librin "Hyrje në Ekonomi", autorët përcaktojnë se bankat kryejnë një aktivitet ekonomik që mbështetet në parime të njëjta me ato të një biznesi të çfarëdoshëm. Veçoritë e këtij biznesi qëndrojnë në specifikën dhe në aktivitetin që kryen banka. Banka është një firmë financiare që kryen shërbime të caktuara, që realizon kalimin e mjeteve të lira financiare nga ata që i kursejnë tek ata që kanë nevojë për to.

Aktiviteti bankar përfshin në radhë të parë pranimin e depozitave të individëve, firmave e të tjera.

Së dyti, aktiviteti bankar përfshin dhënien e huave firmave dhe individëve që kanë nevojë për to. Për këtë shërbim banka kërkon interes, i cili është më i lartë se interesi që ajo jep për depozitat.¹

Bankat komerciale sikurse edhe bizneset e tjera për objektiv të tyre kanë fitimin. Fitimin e bankave e përbën diferenca apo dallimi midis të ardhurave dhe shpenzimeve të cilat realizohen.

¹ Ahmet Mançellari, Sulo Dadëri etj., *Hyrje në ekonomi*, Pegi, Tiranë, 2002. f. 371 dhe 373.

Në të gjitha shtetet sistemi bankar funksionon në dy nivele. Niveli i parë identifikohet me funksionimin e bankës qendrore ndërsa niveli i dytë me funksionimin e të gjitha bankave të tjera.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës është institucion i pavarur, që për aktivitetet dhe operacionet e saj i përgjigjet vetëm Kuvendit të Kosovës, ndërsa kompetencat e veta kjo bankë i ushtron në pajtim me Kushtetutën e shtetit ku aktivitetet e saj janë të rregulluara me ligj.

Në bazë të Ligjit mbi Bankën Qendrore², në nenin 4.2, Banka Qendrore e Kosovës si organ i pavarur publik gëzon autonomi të pavarur në kryerjen e aktiviteteve operuese dhe administrative, njëherësh funksionon dhe vepron jashtë kornizës së strukturave qeveritare të Kosovës.

Me këtë nënkuptojmë se, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës është e pavarur ndaj organeve qeveritare sikurse që është në vende të ndryshme.

Në këtë drejtim, përveç kësaj, Banka Qendrore e Kosovës si institucion financiar vendos rregullat dhe procedurat e brendshme me të cilat udhëheq punësimin e personelit duke përfshirë stafin, këshilltarët, ekspertët dhe prokurimin, bazuar në rregullat e përgjithshme me të cilat drejtohet shërbimi publik.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës i ka objektivat e veta. Ndër objektivat kryesore të Bankës Qendrore të Kosovës janë:

a) Të nxisë sigurinë, aftësinë e pagimit dhe funksionimin efikas të sistemit financiar stabil të bazuar në treg, duke inkurajuar daljen e instrumenteve financiare të sigurta në treg .

b) Të mbështesë politikat e përgjithshme të ekonomisë së Kosovës, me synim të dhënies së kontributit në ndarjen efikase të resurseve në pajtim me parimin e ekonomisë së tregut të lirë.

² Ligji Nr. 03/L-074 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës.

Përveç objektivave të përgjithshme Banka Qendrore ka edhe kompetenca të veçanta. Ndër kompetencat e saj që duhet të potencojmë janë këto:

- t'i rekomandojë udhëzime të gjëra politike Kuvendit dhe Qeverisë,
- të vendosë dhe të zbatojë masat për sistemet e marrëveshjeve mbi transaksionet e valutave vendore dhe të huaja në Kosovë, të mbikëqyrë dhe të rregullojë pagesat,
- të posedojë dhe veprojë me më shumë sisteme pagesash,
- të veprojë si bankar në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave,
- të veprojë si agjent fiskal i Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave,
- të mbajë depozita të valutave të huaja për Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave,
- të sigurojë furnizim adekuat me bankënota dhe monedha për rregullimin e transaksioneve me para të gatshme,
- të mbajë thesar për ruajtjen e sigurt të valutave dhe letrave me vlerë,
- të licencojë, mbikëqyrë dhe rregullojë institucionet financiare,
- të kryejë analiza të rregullta ekonomike dhe monetare të ekonomisë së Kosovës,
- t'i bëjë publike rezultatet dhe të paraqet propozime e masa Kuvendit dhe Qeverisë,
- të mbikëqyrë dhe rregullojë agjentët e shitjes në këmbimin e valutave,
- të miratojë auditorët e jashtëm të institucioneve financiare;
- të vendosë standarde të kontabilitetit për institucionet financiare në Kosovë në harmoni me standardet ndërkombëtare financiare të raportimit e të tjera.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës si institucion financiar ua siguron institucioneve shtetërore, komunitetit financiar dhe publikut shërbimet e rëndomta financiare që ofrohen nga një bankë qendrore, me përjashtim të çfarëdo krediti ose likuiditeti të përkohshëm pasi që nuk është bankë emetuese.

Banka Qendrore është përgjegjëse për sigurimin e një furnizimi të duhur të Kosovës me kartëmonedha dhe me monedha Euro. Furnizimi me euro nga Banka Qendrore bëhet për kryerjen e transaksioneve me para të gatshme në ekonomi.

Meqë në Kosovë euro është valuta kryesore e lejuar për përdorim, si mjet i pagimit dhe qarkullimit, vetëm Banka Qendrore është e autorizuar të bëjë furnizimin e kësaj monedhe.

Përgjegjësitë e Bankës Qendrore janë të lidhur ngushtë me operacionet dhe menaxhimin e parave të gatshme, që kanë të bëjnë me valutën e euros e cila është në përdorim në vendet e eurozonës e më gjerë.

Në këtë drejtim, bazuar në kompetencat të cilat i ka, e të cilat janë të harmonizuara me ligjin e Bankës Qendrore është mundësuar që të funksionojë edhe sistemi i tërësishëm bankar.

Përveç operacioneve, aktiviteteve, produkteve e shërbimeve të cilat janë të harmonizuara me ligjin mbi bankën, Banka Qendrore është përgjegjës edhe për licencimin e bankave komerciale dhe institucioneve të tjera financiare.³

Historia e zhvillimit të sistemit bankar në Kosovë

Në Kosovë bankat komerciale apo bankat private aktivitetin financiar e zhvillojnë që nga pas lufta e fundit, e vitit 1999, pra nga viti 2000. Edhe para luftës në Kosovë funksionin bankat të ndryshme por ato ishin të një sistemi ekonomik e politik të tejkaluar.

Bankat e nivelit të dytë apo bankat komerciale punët e tyre i kryejnë konform ligjit mbi bankat si dhe me udhëzimet e Bankës Qendrore.

Në ekonominë e tregut, aktualisht në territorin e Republikës së Kosovës, bankat komerciale të cilat veprojnë dhe ushtrojnë aktivitetet e tyre si dhe filialet apo degët e tyre që i kanë shtrirë në tërë hapësirën e saj janë:

1. Banka Ekonomike (aktivitetin financiar e filloi më 28 maj të vitit 2001)

³ Institucionet e regjistruara financiare në Bankën Qendrore janë: Bankat Komerciale, Kompanitë e Sigurimeve, Institucionet Mikrofinanciare, Institucionet Jobankare, Agjencitë për transferin e parave dhe Këmbimoret.

2. Banka për Biznes (veprimtarinë e vet bankare e filloi më 5 prill të vitit 2001
3. NLB Pishtina
4. ProCredit Bank (aktivitetin e saj në Kosovë, nga periudha e pasluftës)
5. Raiffeisen Bank Kosovo J.S.C (Në qershor të vitit 2003)
6. Banka Kombëtare Tregtare (e filloi punën në vitin 2007)
7. TEB Sh. A. Bank (ka filluar më 2 Janar të vitit 2008)

Këto banka, të gjitha së bashku kanë kryer një funksion të vlefshëm për ekonominë e Kosovës, për investime në këtë ekonomi dhe për depozitat e qytetareve.

Vërehet një rritje e depozitave që në një mënyrë e pasqyron zhvillimin e bankave dhe produkteve të tyre.

Në vazhdim të punimit kemi pasqyrën e depozitave të klientëve në bankat komerciale në Kosovë, për periudhën nga viti 2000 deri në vitin 2010.

Tabela nr.1. Pasqyrë e depozitave në bankat komerciale të klientëve në periudhën 2000 deri 2010.

Përshkrimet	Depozitat - periudha nga viti 2000-2010										
	Dinamika mujore e depozitave nëpër vite										
Vitet	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010
Janar		105.6	431.4	441.1	536.0	691.0	839.3	942.6	1,153	1,422	1,754
Shkur		107.3	433.6	440.9	537.3	703.5	856.1	973.5	1,150	1,445	1,775
Mars		114.5	392.9	435.9	563.6	709.7	825.3	973.5	1,183	1,469	1,777
Prill		120.4	388.4	438.2	559.0	712.6	825.3	967.7	1,196	1,466	1,747
Maj		133.2	382.5	437.9	568.2	731.2	825.2	984.6	1,236	1,501	1,750
Qersh.		152.2	386.3	454.3	577.5	742.2	845.4	981.6	1,265	1,513	1,752
Korrik		170.1	380.8	477.7	608.0	746.3	846.9	1,027	1,317	1,553	1,734
Gusht		186.4	398.0	495.9	616.1	765.8	884.8	1,074	1,373	1,617	1,797
Shtat.		198.0	398.0	490.7	633.1	790.3	887.7	1,061	1,404	1,646	1,805
Tetor		207.6	404.8	505.9	628.0	784.3	889.0	1,103	1,415	1,640	1,757
Nënt.		245.2	406.2	501.5	648.1	808.6	910.5	1,125	1,387	1,649	1,836
Dhjet.	93.0	492.3	427.2	514.0	694.5	836.7	924.3	1,143	1,444	1,745	1,952

Burimi: - Raportet nga Banka Qendrore e Kosovës vitet 2000 deri 2010.

- Të dhënat janë të përpunuara.

Në tabelën nr.1, është pasqyruar shuma e mjeteve të depozituara në bankat komerciale, nga klientët e ndryshëm. Të dhënat në tabelë janë të përpunuara ku shihen parametrat mbi zhvillimin e depozitave, dinamika e rritjeve nëpër muajt gjatë viteve, si dhe shtimi i depozitave prej vitit në vit.

Derisa në fund të vitit 2000, shuma e depozitave të klientëve në banka ishte 93 milionë €, ndërsa në fund të vitit 2010 depozitat janë rritur në vlerë prej 1 miliard e 952 milion euro.⁴

Tabela tregon se në vendin tonë depozitat e klientëve janë të mëdha karshi besimit që kanë dhe dilemave që kishin ndaj bankave në njërën anë, si dhe pozitës e zhvillimit ekonomik të vendit në anën tjetër.

Sistemi kreditor në funksion të zhvillimit të ekonomisë

Kreditë janë ndër aktivitetet kryesore të bankës prej nga banka klientëve u lejon mjete financiare.

Bankat komerciale përmes kredive të dhëna, e të normës së interesit të caktuar, sigurojnë të ardhurat e veta të cilat i nevojiten për t'i paguar depozituesve të saj interesin e premtuar për depozitat e marra, si dhe për të përballuar shpenzimet e veta dhe për të siguruar fitimin që bankat kanë për objektiv të tyre.

Me një fjalë, kreditimi i individëve, biznesit dhe subjekteve të tjera të cilat kërkojnë kredi në banka është procesi i dhënies hua të fondeve të vendosura në bankë, i cili bazohet sipas kushteve të rëna dakord midis vetë bankës dhe të huamarrësve.

Funksioni i kreditimit të mjeteve që i dedikohet klientëve është funksioni kryesor i përdorimit të fondeve financiare.

Një nga aktivitetet kryesore të bankave komerciale edhe dhënia e kredive për klientët e tyre.

Në sferën e veprimit të sistemit kreditor të Kosovës, për klientët e vet, bankat komerciale të cilat funksionojnë dhe që ushtrojnë aktivitetin e tyre ofrojnë këto lloje të kredive:

1. Kredi konsumuese, të llojeve të ndryshme,

⁴ Raporti i Bankës Qendrore të vitit 2010.

2. Kredi për përmirësimin e kushteve të banimit,
3. Kredi për zhvillimin e biznesit, zhvillimin e NVM,
4. Garancinë bankare e tjera.

Në Kosovë, në saje të zhvillimit të sistemit kreditor, në kohën e fundit ka filluar të përhapet kredia hipotekare, që konsiderohet një sukses i arritur i zhvillimit të produkteve të bankave komerciale.

Bazuar nga karakteristikat dhe rëndësinë që ka sistemi kreditor në zhvillimin ekonomik të vendit, kreditë e bankave apo kreditë komerciale, edhe pse kanë normat e larta të interesit për to, në një mënyrë dhe në një masë kanë ndikuar në zhvillimin e proceseve ekonomike si dhe në zhvillimit e këtij sistemi.

Me zhvillimin e sistemit bankar dhe të kredisë me të madhe është zhvilluar edhe sistemi kreditor. Ky sistem i funksionimit ka bërë që jo vetëm të rritet numri i kredive por edhe shumica e mjeteve të lejuara, në këtë formë të shtohet hovshëm prej viti në vit.

Në këtë drejtim, si rezultat i nevojave dhe kërkesave të mëdha të qytetarëve dhe e ekonomisë për kredi, pra edhe përkundër normave të larta të interesit të cilat funksionojnë në sistemin e sotëm kreditor, prapë se prapë dinamika a tyre është zhvilluar mirë.

Tabela nr.2. Pasqyrë e kredive të bankave komerciale të lejuara për qytetarët e subjekteve ekonomike në periudhën e vitit 2000 deri 2010.

Përshkrimet		Kreditë (periudha 2000-2010)									
		Dinamika mujore e kredive në vite									
Muajt	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010
Janar		3.5	29.8	90.4	240.6	381.8	520.1	639.5	902.5	1,189	1,293
Shkut		4.0	34.0	102	252.8	396.7	533.0	662.3	937.0	1,211	1,298
Mars		5.0	47.6	116	268.1	414.4	555.4	687.7	970.2	1,230	1,336
Prill		7.1	51.2	134	281.0	433.1	588.9	716.4	1,020	1,239	1,360
Maj		8.4	56.6	146	297.5	457.6	604.5	748.2	1,053	1,268	1,381
Qersh		10.7	58.7	163	313.7	466.2	617.1	784.4	1,090	1,281	1,405
Korrik		13.0	61.6	171	328.0	471.0	612.4	790.8	1,114	1,274	1,413
Gusht		13.9	65.3	177	336.0	468.8	616.4	803.9	1,124	1,265	1,407
Shtat		14.9	68.2	188	350.1	476.9	620.7	825.0	1,131	1,279	1,419
Tetor		16.7	75.4	206	364.5	489.2	620.7	852.0	1,161	1,292	1,428
Nënt		21.3	76.9	217	373.8	508.5	629.5	877.1	1,188	1,299	1,453
Dhjet	3.3	25.9	86.5	233	373.7	513.9	636.6	892.1	1,183	1,289	1,439

Burimi: - Raportet nga Banka Qendrore e Kosovës vitet 2000 deri 2010. Të dhënat në tabelë janë të përpunuara.

Derisa në fund të vitit 2000, kur filloi të funksionojë sistemi bankar dhe kreditor, shuma e kredive të lejuara për klientët, individët dhe bizneset kishte arritur në një shumë prej 3 milionë euro, në dhjetor të vitit 2010 shuma e kredisë për këto kategori arriti në vlerë prej 1 miliard e 439 milionë Euro.⁵

Kushtet dhe kriteret e kredive të bankave komerciale

Bankat kryesisht ofrojnë kredi konsumuese në blerjen e mallrave të ndryshme nga programi i produkteve të ndërmarrjeve të caktuara.

Shuma e mjeteve të kreditimit është e caktuar deri në 1/3 të pagës mujore.⁶ Anuiteti mujor i kredisë është deri 1/3 e pagës. Në këto raste klientët marrin dokumentacionet në bankë ku edhe e bëjnë procedimin e kredisë.⁷

Normat e larta të interesit të bankave nuk rrjedhin nga kreditë e këqija

Me aktivitetet dhe operimet e tyre, bankat komerciale realizojnë fitime të mëdha duke aplikuar norma të larta të interesit për kreditë e dhëna.

Për normat e larta të interesit të cilat dominojnë aktualisht bankierët para klientëve, subjekteve ekonomike e të tjerëve arsyetohen në atë se ekzistojnë faktorë të ndryshëm, se gjoja bankat i përcjellin rreziqe të ndryshme, nga moskthimi i kredive në periudhën e caktuar të klientëve, si rezultat i dominimit të kredive të këqija.

⁵ Raporti i Bankës Qendrore të Kosovës i vitit 2010.

⁶ Kreditë e tilla u lejohen individëve të cilët janë në marrëdhënie të punës.

⁷ Klientët gjejnë dhe caktojnë garantues. Duhet të jenë persona të cilët punojnë, posedojnë kontratën e punës dhe shikohet historiat e kartelës. Zyrta e kreditor e informon klientin për aprovimin apo mos aprovimin e kredisë.

Pra, edhe pse bankat kanë normat e larta të interesit për kreditë, në Kosovë kreditë e këqija janë më të ulëta se në vendet e rajonit e më gjerë.

Kohë më parë, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD) ka paralajmëruar se vendet e Evropës Lindore mund të përballën me një valë të dytë të krizës financiare, si pasojë e rritjes së fortë të kredive të këqija dhe vështirësive financiare të biznesit.

Pra, BERZH paralajmëron se kreditë e këqija po rriten në mbarë rajonin, por në disa vende si Turqia, Shqipëria, Rumania dhe Ukraina ato janë dyfishuar brenda një viti.⁸

Kohë më parë është bërë publike lista, përkatësisht renditja e vendeve të rajonit më problematike me kreditë e këqija. Lista kryesohet nga Serbia që merr pjesë me 17.5 % dhe Mali i Zi me 17.2 % të kredive të këqija nga totali i kredive të lejuara. Në vend të tretë vjen Shqipëria me 12.87 % dhe pastaj Maqedonia me 9.9%, Kroacia me 9.5% dhe Bosnja me 8.7 për qind.⁹

Të dhënat e Bankës së Shqipërisë tregojnë se në periudhën prill - qershor 2010 ritmi i rritjes së kredive të këqija ka rënë në 7 % nga 19,7 % të regjistruar në tremujorin e parë të vitit 2009. Në fund të vitit 2009 ishte 10.42 %, ndërsa këtë vit (viti 2010) ka arritur në 12.2 %.¹⁰

Në raport thuhet se përqindjen më të madhe në kreditë e këqija e zënë këto, për bizneset marrin pjesë me 13.8 % dhe më pas kreditë për individë me 10.3 %, ku pjesa më e madhe e shumës është në monedhë të huaj.¹¹

⁸ Raporti i Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), Publikuar më 28. Korrik 2009.

⁹ Shoqata e Bankave të Republikës së Shqipërisë Informatë. Burime nga Interneti.

¹⁰ Raporti i Bankës qendrore të Republikës së Shqipërisë, viti 2010.

¹¹ Në Republikën e Shqipërisë kreditë me monedhë të huaj si p.sh. në dollar amerikan dhe në euro, bankat aplikojnë norma më të ulta të interesit, ndërsa më valutën kombëtare në lek normat e interesit janë më të larta.

Tabela nr. 3 Kreditë e këqija në periudhën 2006 deri në vitin 2009 si dhe në gjashtëmujorin e parë të vitit 2010.

N.r.	Vitet	Kreditë e këqija (pjesëmarrja në gjithsej kreditë e lejuara)
1.	2006	4.1%
2.	2007	4.1 %
3.	2008	3.3 %
4.	2009	4.3 %
5.	Qershor 2010	4.5 %

Burimi: Banka Qendrore e Kosovës.

Në Republikën e Kosovës, që nga fillimi i funksionimit të sistemit bankar dhe kreditor, kreditë e këqija, përkatësisht kreditë me probleme deri në vitin 2005 nuk kanë arritur më shumë se 3 për qind nga kreditë e përgjithshme të lejuara.

Siç shihet në tabelën numër 3, argumentohet edhe kjo, se në vitin 2006 kreditë e këqija kanë qenë 4.1 për qind në raport me kreditë e përgjithshme.

Me këtë trend, kjo përqindje ishte edhe në vitin 2007. Në vitin 2008 kemi një rënie të saj në 3.3 për qind, ndërsa në vitin 2009 kemi një pjesëmarrje me 4.3 për qind, si dhe në gjashtëmujorin e vitit 2010 me 4.5 për qind.

Nga të dhënat të cilat tregojnë, si dhe të bazuara nga volumi e dinamika e depozitave, kredive dhe të kredive të këqija shihet se bankat të cilat operojnë në vendin tonë janë të shëndosha dhe të qëndrueshme financiarisht. Për të qëndruar në këtë pozitë dhe për t'u zhvilluar edhe më shumë, si dhe për ta zvogëluar pjesëmarrjen e kredive me probleme, bankat duhet të kenë kujdes në dhënien e kredive për klientët e tyre si dhe t'i ulin normat e interesit.

Për të evituar huadhënien tek ata individë apo biznese që nuk janë të sigurt që i kthejnë me kohë kreditë e marra, për t'iu shmangur rritjes së mëtejshme të nivelit të kredive të pakthyera, kjo mund të arrihet duke i ulur normat e interesit por edhe afati i kthimit të zgjatet, atëherë kredimarrësit më lehtë do t'i kthejnë kreditë pasi që më shumë mundësohet zhvillimi i tyre.

Njohuritë e klientëve për kreditë dhe produktet

Klientët të cilët marrin kredi duhet të hulumtojnë tregun bankar para se të aplikojnë në mënyrë që të kenë kushte me të mira, edhe pse në mes të bankave ekzistojnë ndryshime të vogla të kriterëve mes tyre. Për këtë është i nevojshëm informimi i qytetareve, klientëve, për produktet e shërbimet bankare, për plotësimin e kërkesave të tyre si dhe intensifikimi i aktiviteteve të bankave me qëllim të përballimit të konkurrencës që ka arritur deri te shtimi i produkteve të reja te këto.

Në kushtet ku niveli i njohurive i klientëve të bankave ka ndikuar nga një sërë faktorësh si: shumëllojshmëria dhe sofistikimi i produkteve e shërbimeve financiare, zhvillimi i shpejtë i teknologjisë, lëvizjet demografike të popullsisë nga zonat rurale në ato urbane, kërkesat për financat, për kredi e shërbime të tjera, kanë bërë që huadhënia të jetë më e përhapur, Mirëpo si pasojë e kësaj, mungesa e njohurive ndaj saj e bën të pamundur marrjen e informacionit në kohën e duhur.¹²

Rekomandimet

Në kuadër të shqyrtimit të problematikës së sistemit bankar dhe të sistemit kreditor si dhe të mundësisë së zhvillimit të mëtutjeshëm të këtij sistemi japim këto rekomandime:

1. Banka Qendrore të angazhohet që t'i licencojë bankat e reja, për të shtuar bankat komerciale, sidomos ato vendore, me qëllim që të shtohet konkurrenca, ku efektet dhe ndikimi në zhvillimin ekonomik do të jetë më i madh se deri tani.
2. Në këto rrethana propozojmë të shqyrtohet mundësia e inicimit të një politike të re kreditimi, të aplikohen përqindje më të ulëta të

¹² Eugenie Gjuraj: Sistemi banker dhe biznesi si faktorë zhvillimi. Interneti. E vendosur më datën 15.09.2009. Autorja është Drejtore Ekzekutive, Dhoma e Tregtisë & Industrisë, Tiranë.

normave të interesit si dhe zgjatja e afatit të shlyerjes së kredive për disa sektorë perspektivë, me qëllim që ato të mbështeten më tepër.

3. Të ndërmerret një iniciativë për realizimin e një projekti në drejtim të organizimit të përbashkët të institucioneve bankare, pra në krijimin e një qendre informatave për qytetarët dhe subjektet ekonomike, të cilat kërkojnë kredi apo japin depozita (kursime) në institucionet financiare, me qëllim që të kenë informata të mjaftueshme për kushtet dhe kriteret e tyre.

Bibliografia

Mançellari, Ahmet. Dadëri, Sulo., Kule, Dhori dhe Qiriqi, Stefan. *Hyrje në Ekonimi*, Pegi, Tiranë, 2002.

Maqellari, Alqi. 2007. *Makroekonomia*. Tiranë.

Komoni, Sabahudin. *Financat*. Prishtinë, 2008.

Abazi. Vokshi, Arjeta. Haderi, Sulo. 2008. *Aspekte të ndryshme të politikës monetare në Shqipëri*. Revista ekonomike, *Ekonomia & Biznesi*, Nr.1 3(29), Fakulteti i Ekonomisë, Tiranë, 2008.

Ligji Nr. 03/L - 074 për Bankën Qëndrore të Republikës së Kosovës.

Rregullorja nr. 1999/21, UNMIK/ REG/ 21, 15 nëntor 1999 mbi "Licencimin, mbikëqyrjen dhe rregullimin e bankave", seksioni 2.

Raporti i Bankës Evropiane për Rindertim dhe Zhvillim (BERZH). Publikuar më datën 28 korrik 2009.

Raporti i Bankës qendrore të Republikës së Shqipërisë, viti 2010.

Raporti i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, viti 2010.

Informatë: *Shoqata e Bankave të Republikës së Shqipërisë*. Burime nga Interneti.